

STAFI POLITIK

VALDETE BIZHGA

Znj. Valdete Bizhga mban pozicionin e drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit që prej vitit 2013. Ajo ka kryer një sërë funksionesh, si: nënkryetare e Bashkisë Tiranë, drejtore e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, drejtore projekti në Njësinë e Menaxhimit të Programeve pranë UNFPA-së, drejtore projekti për shërbimet sociale me bazë komunitare pranë Bankës Botërore. Karriera e saj ka nisur pranë Institutit të Shëndetit Publik në pozicionin e specialistit, duke vijuar më pas si: shefi sektori, shefe reparti, duke e përmbyllur në pozicionin e shefit të Departamentit. Gjithashtu, znj. Bizhga ka mbajtur edhe pozicionin e pedagogut të jashtëm pranë Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, si dhe ka ofruar ekspertizën e saj si eksperte e jashtme.

Znj. Bizhga i ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, dega “Mjekësi e përgjithshme”. Ajo ka kryer studimet “Master në shkencat për menaxhim në shëndet publik” në Londër. Znj. Bizhga mban titullin “Profesor i Asociuar” në shkencat mjekësore. Gjithashtu, ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e shëndetit publik, politikave mjedisore, në fushën e lidërshimit, menaxhimit të projekteve, vlerësimit të performancës, ndërmjetësimit, politikave sociale etj.

LEDIA TOTA

Ledia Tota arkitekthe, mban pozicionin e Këshilltares për planifikimin e territorit. Pas mbarimit të studimeve pranë fakultetit të arkitekturës në Universitetin e Tiranës transferohet pranë Universitetit Politeknik të Torinos në Itali, ku diplomohet në profilin “Arkitekturë”. Ka një përvojë pune kombëtare dhe ndërkombëtare, 20 vjeçare dhe zotëron njohuri të thella në fushën e planifikimit, projektimit, menaxhimit dhe mbikqyrjes së projekteve arkitektonike, publike dhe private, si dhe njëkohësisht eksperte koordinatorë e këtyre projekteve.

Karriera ka nisur në Torino, në vitin 2003 deri 2006, dhe është pasuar me bashkëpunime dhe projekte të ndryshme publike, arkitekturore.

Në 2006 transferohet në Shqipëri dhe deri në 2010 angazhohet masivisht në projekte të rëndësishme publike dhe private në fushën e projektimit dhe planifikimit.

E angazhuar si arkitekt-planifikues, bashkëpunëtorë dhe koordinatorë pranë Bashkisë Durrës për Planin Rregullues të Bashkisë Durrës si dhe projekteve të rivitalizimit urban.

Në 2007-2012 kontribuon në fushën akademike dhe publikimeve pranë Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin Polis dhe Universitetin Epoka.

Nga viti 2015-2023 ka drejtuar Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.

GENTIAN SALA

Z. Gentian Sala shërben si këshilltar dhe koordinator i Sekretariatit Koordinues Ndërqeveritar Shqipëri – Kosovë, pranë Kabinetit të Kryeministrit. Më parë, z. Sala është zgjedhur nga Kuvendi si kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive, detyrë të cilën e ka ushtruar për 7 vite. Z. Sala ka qenë për 5 vite drejtor i projektit “Blej shqip”, një organizatë jofitimprurëse që merret me promovimin e prodhimeve shqiptare. Ai ka një eksperiencë dhjetëvjeçare si administrator dhe njëkohësisht aksionar në kompani të ndryshme shqiptare.

Z. Sala ka qenë aktivist prej katër vitesh në Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Ai ka marrë pjesë në disa projekte dhe aktivitete nga ku mund të përmendim mbledhjen e fakteve dhe dëshmive të gjenocidit të ushtruar ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë periudhës së luftës në vitin 1999 si dhe pjesëmarrjen e tij në projektin e monitorimit të burgjeve dhe dhomave të paraburgimit në Shqipëri.

Z. Sala është diplomuar për drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës në vitin 2001 dhe ka kryer studime të nivelit “Master” për “Studime evropiane” në Universitetin e Tiranës. Ai mban titullin avokat që nga viti 2004.

ODETA BARBULLUSHI

Znj. Odetta Barbullushi shërben si këshilltare e Kryeministrit dhe Koorditore Kombëtare për Zonën Ekonomike Rajonale (Tregu i Përbashkët Rajonal që nga viti 2020) pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Znj. Barbullushi ka shërbyer më parë si drejtore e kabinetit të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme (2017-2019) dhe zëvendësministre për Punët e Jashtme (2015-2017). Znj. Barbullushi vjen nga fusha akademike, ku ka mbajtur pozicionin e lektore dhe Zëvendësrektore për Kërkim pranë Universitetit Evropian të Tiranës (2010-2015).

Znj. Barbullushi mban titullin “Doktor i Fologjisë” (PhD) në studime ruse dhe të Evropës Lindore, nga Universiteti i Birminghamit, Mbretëri e Bashkuar, diplomën “Master në Studime Bashkëkohore Evropiane” nga Universiteti i Sussex, Mbretëri

e Bashkuar, dhe “Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare” nga Universiteti i Evropës Qendrore, Budapest/Vjenë. Gjatë vitit 2014 ka kryer kërkime post doktorale pranë Universitetit Karl Franzen Graz, Austri.

ELORA KOKALARI

Znj. Elora Kokalari mban postin e këshilltarit në Kabinetin e Kryeministrit dhe drejton Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ajo vjen nga një eksperiencë e gjatë në qeverisje dhe menaxhim projektsh.

Më parë, znj. Kokalari ka shërbyer si drejtoreshë e kabinetit të ministrit të Brendshëm, ku ka dhënë kontribut në implementimin e politikave në sigurinë publike, luftën kundër krimit të organizuar dhe për pushtetin vendor. Eksperienca e saj në qeverisje shtrihet në drejtimin e Njesisë së Jetësimit të Prioriteteve pranë Kryeministrit dhe me parë koordinimin ndërsektorial në zbatimin e prioritetit të shërbimeve publike. Ajo ka nisur karrierën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka shërbyer si analiste biznesi pranë Quebecor World, Chicagoe, më pas si specialiste marketingu pranë Fondacionit Chaffey College” në Kaliforni. Me kthimin në Shqipëri, ajo drejtoi sektorin e marketingut pranë “Infosoft Systems e, më pas, punoi në sektorin e arsimit të lartë, ku krahas mësimdhënies, ajo punoi në zyrën e zhvillimit të biznesit pranë universitetit “Marin Barleti”.

Znj. Kokalari mban diplomën “Bachelor of Science pranë California State Polytechnic University, Pomona, në degët “Biznes ndërkombëtar” dhe “Menaxhim marketingu”. Ajo, gjithashtu, mban diplomë të asociuar në Administrim Biznesi nga Chaffey College në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

ADNOR SHAMETI

Z. Shameti shërben si Këshilltar ligjor në zyrën e Kryeministrit të Shqipërisë, që prej shtatorit të vitit 2021. Në vitin 2017 zgjidhet deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Legjislaturën e IX, duke përfaqësuar qarkun e Beratit. Z. Shameti ka përfunduar me medalje ari studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Juridik, Tiranë. (1991 - 1995) dhe punësohet menjëherë pas studimeve si pedagog pranë këtij fakulteti. Që prej vitit 1995 e në vazhdim, ushtron profesionin e avokatit dhe njëherazi është anëtar i Dhomës së Avokatisë, Tiranë. Prej vitit 2006 deri në vitin 2014 ka qenë drejtues në një universitet privat. Në vitin 2008, z. Shameti mbron gradën Doktor i Shkencave në Drejtësi. Ai ka kualifikime të shumta në vende të BE-së dhe SHBA-së si dhe pjesëmarrje në konferenca të shumta, brenda dhe jashtë vendit.

Z. Shameti ka kryer specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit, Hollandë në vitet 1993-1994. Z.Shameti është autori i parë dhe bashkëautor në botime dhe artikuj shkencor të publikuar, brenda dhe jashtë vendit. Ai zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane.

BESION HASAJ

Z. Besion Hasaj shërben si analist në kabinetin e Kryeministrit, në fushën e energjisë dhe infrastrukturës. Gjatë kësaj kohe z.Hasaj ka ndjekur zbatimin e politikave në fushën e energjisë, infrastrukturës, burimeve natyrore, transportit rrugor, transportit detar si edhe reformimin e sektorit të ujësjellës dhe kanalizimeve. Z. Hasaj ka eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si Drejtues në Drejtorinë e Financës dhe Tregtisë në shoqërinë aksionare me kapital 100 % shtetëror “Illyrian Guard” për një periudhë 2 vjeçare. Në sektorin privat, angazhimi i tij ka qënë në fushën e tregtisë dhe menaxhimit financiar në pozicionin specialist dhe menaxher në sektorin e automobilëve, energjisë dhe ndërtimit.

Z. Hasaj mban diplomën “DND” në Fakultetin e Ekonomisë dega Financë, në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu z. Hasaj ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e financave, kontabilitetit dhe atyre kompjuterike.

AIDA HASMETA

Znj. Aida Hasmeta shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatësprej vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe, znj. Hasmeta ka ndjekur zbatimin e politikave kryesore në fushën e shëndetësisë, çështjeve sociale, shërbimeve publike dhe digjitalizimin. Mëherët, ka shërbyer si koordinator pranë kësaj njësie për çështjet e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës.

Znj. Hasmeta vjen nga një eksperiencë e gjatë në monitorimin dhe hartimin e politikave, si edhe të dokumenteve strategjike. Ajo ka nisur karrierën e saj në Ministrinë e Shëndetësisë ku ka shërbyer si specialiste e monitorimit dhe vlerësimit të informacionit shëndetësor dhe është angazhuar në grupet e punës për monitorimin e programeve të qeverisë, hartimin e strategjisë së shëndetësisë, planit të veprimit të promovimit shëndetësor, koordinimin sektorial dhe ndërsektorial për konsultimin publik, monitorimin e fëmijëve në rrezik braktisjeje shkolle, zbatimin e akademisë së shëndetit në shkolla etj. Më parë është angazhuar me organizata joqeveritare me projekte në çështjet sociale dhe të arsimit.

Znj. Hasmeta është diplomuar në Universitetin e Mjekësisë Tiranë për “Mjekësi të përgjithshme”. Gjithashtu, ajo ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e politikave shëndetësore të fokusuara në mbulimin shëndetësor universal, të ofruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik Zviceran.

ALKIDA THANA

Znj. Alkida Thana shërben si analist në Kabinetin e Kryeministrit, në Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ajo vjen nga një eksperiencë 22-vjeçare në fushën e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjes civile dhe sigurisë kombëtare. Në angazhimet e mëparshme, znj. Thana ka shërbyer si analist i informacionit kriminal për krimin e organizuar dhe korrupsionin në Policinë e Shtetit, organizimin e punës për shpalljen, ndjekjen, organizimin për kapjen e personave të kërkuar nga drejtësia dhe si oficer i Policisë Gjyqësore.

Znj. Thana mban diplomën “Bachelor” në Akademinë e Rendit Publik, Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë nga Fakulteti i Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, licencë për ndërmjetësim dhe licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit. Znj. Thana ka kryer dhe një sërë kualifikimesh profesionale nga institucione të ndryshme, si EUROPOL, PAMECA, UN, Akademia Diplomatike Shqiptare, ICITAP etj, në fushën e analizës dhe teknikës analitike, përpunimit të informacionit dhe përdorimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit kriminal, ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vlerësimit të kërcënimit nga krimi i organizuar dhe krimet serioze (SOCTA), ndërtimit të institucioneve për anëtarësimin në BE, përafrimin e legjislacionit, dhunën në familje, lidërshipi dhe menaxhimin e krizave etj.

ARDIT DRENOVA

Z. Ardit Drenova shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit, Njësia e Koordinimit me Qeverinë.

Z. Drenova vjen nga një eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si shef i financës dhe menaxhimit të riskut në OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit), dhe si audit i lartë pranë KPMG Shqipëri.

Z. Drenova ka përfunduar studimet universitare në nivelin “Bachelor” pranë American University in Bulgaria, Blagoevgrad, në fushën ekonomi, me specializim në matematikë dhe shkencë kompjuterike.

ANDI MAZI

Z. Andi Mazi shërben si analist në Kabinetin Kryeministrit, në Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ai vjen nga një eksperiencë e gjatë në qeverisje dhe hartim e monitorim politikash dhe strategjish. Më parë, z. Mazi ka shërbyer si analist në Njësinë e Jetësimit të Prioriteteve, ku ka siguruar ndjekjen dhe zbatimin e politikave për formalizimin e tokës bujqësore, një nga prioritetet e qeverisë. Eksperienca e tij nëqeverisje përfshin koordinimin ndërsektorial në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe strategjive të lidhura me fushën e mirëqeverisjes. Gjithashtu, ai ka shërbyer si menaxher për projektin “Zhvillimi i sistemit të planifikimit të integruar të politikave” (IPSIS) dhe si Koordinator Kombëtar për Konsultimin Publik. Ai ka nisur karrierën e tij në Ministrinë e Integrimit Evropian ku ka shërbyer si përgjegjës i sektorit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut dhe më parë si specialist në të njëjtin sektor.

Z. Mazi zotëron një diplomë LL.M në të Drejtën Europiane nga Universiteti i Maastricht në Holandë dhe një diplomë “Bachelor” nga universiteti “Luarasi” në drejtësi. Ai, gjithashtu, ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e hartimit të legjislacionit dhe sigurisë ndërkombëtare.

FLORIAN SPAHIU

Z. Florian Spahiu mban pozicionin e analistit pranë Kabinetit të Kryeministrit dhe drejtorit të Protokollit të Kryeministrit. Më parë ka shërbyer si ndihmës i Kryeministrit për Protokollin (2016-2019), ka punuar në Departamentin e Administratës Publike si ekspert në sektorin e koordinimit të projekteve dhe donatorëve (2014-2016), ka punuar në Qendrën për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore, si menaxher projekti në Selanik, Greqi (2013-2014), ekspert përtë drejtat e njeriut pranë Institutit Evropian të Tiranës (2011-2013). Më herët gjatë vitit 2011 ka qenë studiues dhe hulumtues në Institutin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Strategji për 5 muaj në Paris, Francë.

Gjatë vitit 2010 ka kryer praktikën në Komisionin Evropian pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Politikave të Fqinjësisë së Mirë në Bruksel, Belgjikë. Nga viti 2009 deri në vitin 2010 ka punuar si ekspert i marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Institutit Evropian të Tiranës. Gjatë vitit 2008 ka shërbyer si koordinator i Qendrës së Studimeve Evropiane “Jean Monnet” në Universitetin Kristal, Tiranë. Nga 2005- 2007 ka shërbyer si drejtor projekti për Liqenin Manskuria pranë Rodeco Consulting GMBH. Në vitet 2001-2003 ka punuar pranë AMC-së në Tiranë për kujdesin ndaj klientit.

Z. Spahiu mban diplomën “Master në politikat e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare” nga Instituti Evropian për Studime të Larta Ndërkombëtare në Nisë, Francë dhe Instituti për Politikën Evropiane në Berlin, Gjermani (2009). Gjatë viteve 2007-2008 ka kryer studime të nivelit “Master” për administrim biznesi, në Universitetin “Bordeaux IV Montesquieu” në Bordo, Francë. Më herët ka kryer studime të nivelit “Master” për gjuhën gjermane në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (2001-2005).

Gjithashtu, ka kryer trajnim për studime kërkimore në Universitetin e Marburgut dhe Universitetin e Këlnit në Gjermani në 2004. Gjatë 2003 ka kryer kursin ndërkombëtar për gjuhë gjermane, ekonomi dhe studime politike në Universitetin e Këlnit, Gjermani. Gjatë vitit 2000 ka kryer një trajnim për Integrimin Ballkanik dhe Demokracinë në Fondacionin “Körber” në Berlin, Gjermani.

Z. Spahiu është njohës i shkëlqyer i gjuhës gjermane, franceze, angleze dhe italiane.

INA MEMISHAHI

Znj. Ina Memishahi shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit. Më parë, znj. Memishahi ka shërbyer si ndihmës i Kryeministrit, ku ka siguruar administrimin dhe procedimin e korrespondencës ditore pranë Kabinetit të Kryeministrit. Ajo ka një përvojë të konsiderueshme pune në sektorin privat dhe publik, si: sekretare ndihmëse, sekretare, sekretare e parë, kryesekretare dhe asistente dekani në institucionet e arsimit të lartë. Znj. Memishahi ka punuar si asistente noteri, si dhe sekretare e Kryeministrit e asistente e drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit.

Znj. Memishahi i ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega gjeografi, dhe mban titullin specialist i gjeografisë. Gjithashtu, znj. Memishahi ka kryer studimet “Master në administrim publik”. Ajo ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën mjedisore, për mbetjet e riciklueshme, për statistikat, për hartimin e standardeve profesionale pedagogjike në mbështetje të profesioneve të rregulluara me ligj etj.

ENIO OHRI

Z. Enio Ohri shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ai vjen nga një eksperiencë pune në organizatat e shoqërisë civile, ku ka shërbyer si koordinator i projekteve. Më parë, z. Ohri ka shërbyer pranë Kabinetit të Kryeministrit, si ndihmës.

Z. Ohri mban diplomat “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” për administrim biznes nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.

JONIDA TARAJ

Znj. Jonida Taraj shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe, znj. Taraj ka ndjekur zbatimin e politikave kryesore në fushën e bujqësisë dhe kulturës.

Znj. Taraj ka eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si Drejtuese në Drejtorinë e Zhvillimit të Shërbimeve pranë Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për një periudhë 5-vjeçare, ku njëkohësisht ka qenë dhe Drejtuese e Njesisë për Menaxhimin e Projekteve IPA (SPO), si dhe ka drejtuar ekipin ADISA Innovation Lab. Gjithashtu ka punuar në projektin ISDA të Bankës Botërore, si konsulente lokale për ofrimin e shërbimeve. Ajo ka nisur karrierën e saj në sektorin e arsimit të lartë, ku krahas mësimdhënies, ka punuar si koordinator e Institutit Barleti për Kërkim dhe Zhvillim, si dhe menaxhere e Qendrës së Karrierës pranë universitetit “Marin Barleti”.

Znj. Taraj mban diplomën “Master i Shkencave” nga Universiteti i Bergamos në Itali, në degën Ekonomi, Inovacion dhe Organizim të Bizneseve në Tregun Global dhe “Bachelor”, në degën e Ekonomiks dhe Biznes nga po i njëjti universitet.

MARSEL PREÇI

Z. Marsel Preçi shërben si ndihmës pranë Kabinetit të Kryeministrit. Z. Preçi vjen nga një experiencë 16 vjeçare në fushën e teknologjisë së informacionit. Më parë, z. Preçi ka shërbyer si drejtor i Sistemeve E-Gov pranë AKSHI-t, përgjegjës i sektorit të rrjetit dhe sistemeve në Drejtorinë e IT pranë Bashkisë së Tiranës, specialist IT në Bashkinë e Tiranës

Z. Marsel Preçi mban Diplomën e Integruar të Nivelit të Dytënë inxhinieri informatike nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

DENADA MARKO

Znj. Denada Marko mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit në Kabinetin e Kryeministrit prej shtatorit 2013. Ajo ka përvojë pune si specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë dhe për vite me radhë si asistente e kryetarit të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, znj. Marko ka punuar si asistente e kryetarit të Partisë Socialiste.

Znj. Marko ka kryer studimet e larta në Universitetin e Bukureshtit, në Fakultetin e Drejtësisë, diplomuar në degën “Juridik”. Ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e të drejtave, sigurisë kombëtare dhe atë të NATO-s etj.

EGESTA MURATAJ

Zj. Egesta Murataj shërben si ndihmëse e Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ajo vjen nga një eksperiencë në sektorin bankar. Znj. Murataj mban diplomën “Master në Bankë & Financë” nga Universiteti King’s College London dhe diplomë “Bachelor në financë” nga University of New York Tirana. Gjithashtu, znj. Murataj ka kryer trajnime në Departamentin e Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe trajnime në kontabilitet, në një sipërmarrje private.

SKËNDER DUKA

Z. Skënder Duka shërben si ndihmës në Kabinetin e Kryeministrit. Në këtë detyrë ai vjen nga një përvojë disa vjeçare në shoqërinë civile, si bashkëpunëtor dhe koordinator projekti. Më parë, z. Duka ka shërbyer në dy legjislatura si zëdhënës i shtypit i kryetarit të Kuvendit. Në këtë angazhim, z. Duka vinte pas një pune mbi dy dekada në shtypin periodik, për të mbërritur tek emërimi i parë, ai i kryeredaktorit të gazetës “Studenti”, organ i rinisë universitare. Ai ka punuar edhe disa vite si pedagog i jashtëm i lëndës së estetikës, në Universitetin e Tiranës.

Ai ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike të Universitetit të Tiranës, në degën e gazetarisë. Më parë ai është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe të Universitetit të Tiranës.

Njëherësh, gjatë viteve të tij të punës, z. Duka është kualifikuar në tematika të tilla, si: "Media dhe transparenca"- Fondacioni “Friedrich Ebert”; “Marrëdhëniet me publikun dhe media”- kualifikim nga Senati Amerikan; "Praktikat Parlamentare dhe Transparenca në Media" -Zagreb, East Ëest Program; "Media dhe qeverisja

elektronike"- OKB, Neë York; "Media dhe informimi publik"; "E drejta e publikut për informacion dhe administrata publike".

Ai ka botuar librin me ese "Dialog i munguar" dhe është bashkëpunëtor në botimin e serisë: "Monitori shqiptar i medias". Zotëron gjuhët anglisht dhe frëngjisht.

KEVIN BUFI

Kevin Bufi mban pozicionin e ndihmësit në Kabinetin e Kryeministrit.

Kevin ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin privat për ofrimin e shërbimeve ligjore, ku ka zhvilluar aftësitë e tij në hulumtim ligjor, konsulencë, hartim të kontratave dhe përfaqësim gjyqësor në firma të njohura ligjore vendase. Prej vitit 2017, është anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Në vitin 2021 është angazhuar në sektorin publik ku ka punuar pranë Avokaturës së Shtetit, duke kontribuar në përgatitjen e strategjisë së mbrojtjes për çështje gjyqësore ndërkombëtare. Në vijim, ka shërbyer si Këshilltar i Kryenegociatorit të Shqipërisë për Negociatat e Anëtarësimit me Bashkimin Evropian, duke luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e progresit të disa kapitujve të integritetit dhe në sigurimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së, si pjesë e ekipit që kontribuoi në hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Kevin ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, ku është diplomuar me rezultate të larta në Fakultetin e Drejtësisë. Ai ka vijuar studimet e thelluara në fushën e së drejtës në disa prej universiteteve më prestigjioze në Evropë, duke u diplomuar me rezultate të larta në Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Arbitrazh pranë Universitetit të Leidenit në Hollandë dhe më pas, në të Drejtë Biznesi Ndërkombëtare dhe Evropiane në Universitetin Katolik të Leuvenit në Belgjikë.

Përtej karrierës profesionale, është i përfshirë në sferën akademike duke u angazhuar pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës si profesor i jashtëm në departamentin e së drejtës publike. Ai ka marrë pjesë gjithashtu në iniciativa të shoqërisë civile dhe programe trajnimi, ndër të cilat në të Drejtë Ndërkombëtare Humanitare pranë Qendrës Grotius në Hagë, klinika ligjore organizuar nga Universiteti i Leuven, Erasmus +, Konferenca Model Nato (pjesë e ekipit fitues dhe më pas gjyqtar) etj.

Kevin zotëron njohuri të thelluara të gjuhës angleze, italiane dhe greke.

INA GJINI

Ina Nepravishta (Gjini), mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Znj. Gjini ka kryer studimet pasuniversitare në Universitetin e Milanos “Bicocca”, në degën shkenca sociale, Fakulteti i Sociologjisë. Ajo mban diplomën “Master i Shkencave” pranë “Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë”, në degën e drejta publike, Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane.

Më parë, znj. Gjini ka punuar si specialiste për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), pranë Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), dhe si asistente pranë Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri.

ISEI DAKOLI

Znj. Isei Dakoli shërben si ndihmës i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2022.

Znj. Dakoli ka përfunduar studimet universitare në nivelin “Master” pranë University of Geneva në Gjenevë, Zvicër, në degën “Science of Statistics”. Gjithashtu, mban diplomën “Bachelor” nga po i njëjti universitet, në fushën e ekonomisë, me specializim në statistikë.

UENDI BELBA

Znj. Uendi Belba shërben si ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Më parë znj. Belba ka shërbyer në Zyrën e Protokollit të Kryeministrit, duke mbajtur korrespondencën zyrtare me Misionet e Huaja të akredituara në Shqipëri, përpiluar letrat zyrtare në kornizën e korrespondencës zyrtare protokollare të Kryeministrit, si dhe duke koordinuar takime, brenda institucionit e një sërë eventesh me partnerë shqiptarë e të huaj, në kuadër të agjendës së Kryeministrit.

Znj. Uendi Belba mban diplomën “Master i Shkencave” në “Politika dhe Qeverisja në Evropë”, pranë Institutit të Studimeve Evropiane (2023), pjesë e Universitetit të Tiranës, si dhe diplomën “Master Profesional” në “Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për Arsimin e Mesëm” (2021), gjithashtu dhe diplomën “Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi” (2019), të dyja pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, pjesë e Universitetit të Tiranës. Studimet e saj znj. Belba i ka përfunduar me rezultate shumë të larta dhe mban medaljet respektive.

Gjithashtu, znj. Belba ka ndjekur një sërë trajnimesh, si: “Supporting Democracy in the Eastern Balkans – Progress and Bridges II, Political Academy 2022”, organizuar nga Fondacioni Qemal Stafa me mbështetjen e Fondacionit Kalevi Sorsa (Finlandë); “EU Institutions and Policy Making”, në kuadër të programit Jean Monnet Chair,

mundësuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar në Institutin e Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës (2022); “EU – China Relationship”, realizuar nga Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane, Instituti Konfuci (2021) etj.

Pjesëmarrëse dhe vlerësuar në evente, si: “Edicioni i IV i Laboratorit të Debatit Universitar – Nga Fjala Tek Veprimi”, realizuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2022-2023), “Lider për një ditë”, “Panairi i shoqërive të nxënësve”, në kuadër të programit Junior Achievement of Albania. Znj. Belba ka disa eksperiencë vullnetare në Bashkinë e Tiranës, në organizimin e “Maratonës së Tiranës”, “Tirana Art Fest” etj., për të cilat është vlerësuar me certifikatat përkatëse të eventeve, por dhe si “Vullnetari i vitit” 2016, 2017, 2018 nga Bashkia e Tiranës.

UJEZA BARDHI

Znj. Ujeza Bardhi shërben si ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit, Zyra e Protokollit të Kryeministrit. Ajo mban diplomën “Masteri i Shkencave” në marrëdhënie ndërkombëtare, specializim në qeverisje dhe të drejta, nga Universiteti The Neë School në Neë York (2020), dhe diplomën “Bachelor” në shkencë politike nga Universiteti i Neë York-ut në Tiranë (2017). Gjithashtu, ka kryer trajnim për koordinimin e reagimit global emergjent gjatë krizave humanitare në Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (2020). Më herët, ka kryer praktika mësimore në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Bashkinë e Tiranës (2018) dhe në Zyrën konsullore të Ambasadës së Kosovës në Shqipëri (2016). Znj. Bardhi ka njohuri të gjuhës angleze, italiane dhe spanjolle.

SARA XHUMBARI

Sara Xhumbari, mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, prej muajit shtator 2022.

Znj. Xhumbari ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në vitin 2002. Prej vitit 2005, mban titullin "Avokat".

Më herët, znj. Xhumbari ka punuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive duke mbajtur pozicionin e Drejtorit dhe Përgjegjës të Sektorit të Drejtorisë Juridike dhe Licencave, si dhe juriste në Ministrinë e Mbrojtjes e organe të qeverisjes vendore.

MARIELA KATRO

Znj. Mariela Katro shërben si sekretare pranë Kabinetit të Kryeministrit, Zyra e Protokollit të Kryeministrit. Më parë, znj. Katro ka shërbyer si redaktore gjuhësore pranë gazetës “Panorama”, redaktore pranë kompanisë “Unison Agency”, si dhe redaktore pranë shtëpisë botuese “Onufri”.

Znj. Mariela Katro mban diplomën “Post Master” në programin e studimit “Marrëdhënie ndërkombëtare” pranë “Albanian University”, si dhe diplomën për gjuhë-letërsi, specialiteti gjuhësi, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Znj. Katro disponon certifikatën e INIMA-s dhe dëshminë e mbrojtjes së gjuhës angleze pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dhe ka marrë pjesë në trajnime në studimet politike, historike, në fushën juridike etj, pranë Akademisë Profesionale “Elita”.

SILDA ANAGNOSTI ÇEPE

Znj. Silda Anagnosti Çepe shërben si ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ajo vjen nga një eksperiencë mbi 20-vjeçare, si juriste në fushën e sigurisë dhe të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në draftimin e legjislacionit të ri, agjendën e të drejtave të njeriut dhe zbatimit të projekteve në fushën e drejtësisë.

Znj. Anagnosti ka një eksperiencë të plotë si në qeverisje ashtue dhe në organizatat ndërkombëtare.

Ajo ka shërbyer si drejtor i kabinetit të Ministrisë së Brendshme dhe më parë këshilltare ligjore në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për 14 vite, ku ka qenë këshilltare ligjore për portofolin e të drejtave të njeriut dhe sigurisë. Ajo ka shërbyer, gjithashtu, për 2 vite pranë Qendrës “Vatra”, duke kryer mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Znj. Anagnosti ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin Bolonjës (Itali) për të drejtat e njeriut dhe institucione politike dhe në Universitetin e (Suedi) për të drejtat e grave dhe përfaqësimin politik. Ajo mban diplomën “Master i Shkencave” në administrim publik nga Fakulteti Ekonomik, i Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar “Jurist” nga Fakulteti i Drejtësisë, i Universitetit të Tiranës.

Krahas tyre ka qenë pika e kontaktit për Shqipërinë për ODIHR-in, Komisionerin Antidiskriminim të OSBE-së, duke realizuar raportimet në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve dhe grupeve vulnerabël dhe, gjithashtu, për legjislacionin në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe krimeve të

urrejtjes. Ajo është trajnere e certifikuar nga ODIHR për të drejtat e njeriut si dhe për vëzhgimin e procesit zgjedhor, ku ka shërbyer dhe si vëzhguese e disa proceseve zgjedhore në Shqipëri dhe jashtë saj. Përgjatë karrierës së saj ka kryer trajnime nga institucione prestigjioze në fushën e negociatave diplomatike, protokollit diplomatik, të drejtat e njeriut, menaxhimit të projekteve, antishpifjen dhe gjuhën e urrejtjes, luftën ndaj dhunës në familje, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, grupit të kontaktit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB, grupit këshillimor kombëtar për barazinë gjinore.

Znj. Anagnosti është autore e disa publikimeve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurisë.

MERITA SALIAJ

Znj. Merita Saliaj mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ajo vjen nga një përvojë pune disa vjeçare në Kryeministri.

Znj. Saliaj ka kryer studimet e larta në fushën e së drejtës dhe është specializuar në të drejtën civile dhe tregtare. Ajo ka kryer gjithashtu një sërë trajnimesh dhe zotëron disa kualifikime në fushën e të drejtës europiane, sigurisë kombëtare dhe antikorrupsionit.